

**D&A ENERGY SH.P.K**

Korçë, Shqipëri, Rruga "1 Maji", Lagja Nr.18, me Nr.pasurie 3/1013+4-N17, vol.60, fq.13, ZK. 8561  
cel : + 355 69 722 6961

email : dna.energji@gmail.com

Korçe me, 30.07.2024

**STATUTI**

**I**

**SHOQËRISË TREGTARE**

**D&A ENERGY SH.P.K**

Blerim Shahollari, i biri i Dashmirit, lindur me, 31.08.1992 ne Korçë dhe banues në Lumalas, Korçë,  
posedues i leternjoftimit me numër personal :J20831023V .

Hartoj Statutin e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9901 datë  
14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqërítë Tregtare", i ndryshuar. Me nënshkrimin e këtij Statuti,  
themeluesi mer përsipër të realizojë e të respektojë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

**KREU I**

**EMRI, ORTAKËT, SELIA, KOHËZGJATJA**

**NENI 1**

**Emri i shoqërisë**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **D&A ENERGY SH.P.K**.
- 1.2 Emri i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar si dhe emri i ortakut duhet të jenë të përmendura  
në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju kundrejtohen të tretëve.
- 1.3 Shoqëria e emërtuar **D&A ENERGY SH.P.K** (më poshtë e quajtur shoqëria ) është një  
shoqëri me përgjegjesi të kufizuar e krijuar në përputhje me legjisacionin e Republikës së  
Shqipërisë Ligjit nr.9901 datë, 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare ", i  
ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar  
të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

**NENI 2**

**Ortakët**

Ortak i vetem i shoqërisë **D&A ENERGY SH.P.K** do të jetë :

Blerim Shahollari, i biri i Dashmirit, lindur me, 31.08.1992 ne Korçë dhe banues në Lumalas, Korçë,  
posedues i leternjoftimit me numër personal :J20831023V .



**NENI 3**  
**Selia**

3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Korçë, Rruga “1 Maji”, Lagjja Nr.18, me Nr.pasurie 3/1013+4-N17, vol.60, fq.13, ZK. 8561 .

3.2 Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera , qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

**NENI 4**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjata e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar. Asambleja e Ortakëve mund ta kufizojë ose ta zgjasë afatin e veprimtarisë së Shoqërisë.

**NENI 5**  
**Vula**

Shoqëria ka vulën me emrin e saj.

**KREU II**  
**OBJEKTI, KAPITALI, TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**NENI 6**  
**Objekti**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktivitetit :

- 6.1 Blerje pasurish te paluajtshme te çfaredo lloji nga individ, person fizik ose/ dhe juridik shqipetar apo nga institucione shteterore Shqiptare .
- 6.2 Prodhim i energjise elektrike nga impiante eolike fotovoltaike, hidrocentrale ;
- 6.3 Marje me qira e pasurive te paluajtshme te çfaredo lloji nga individ, person fizik ose/dhe juridik shqipetar apo nga institucione shteterore Shqiptare .
- 6.4 Blerja dhe shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike nga njësitë e prodhimit të subjekteve të licensuar tek konsumatorët;
- 6.5 Shitia e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatorë të ndryshem privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit;
- 6.6 Per aktivitetin e saj Shoqeria mund te kete interesa ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera, konsorciume te themeluara ose ne themelim e siper, qe kane objekt te ngjashem te veprimtarise me objektin e Shoqerise ose objekti i tyre i sherben qellimit te objektit te Shoqerise .



**NENI 7  
Kapitali**

7.1 Kapitali themeltar i regjistruar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lek i cili zoterohet ne masen 100% nga ortaku i vetem Blerim Shahollari, i biri i Dashmirit, lindur me, 31.08.1992 ne Korçë dhe banues në Lumalas, Korçë, posedues i leternjoftimit me numër personal :J20831023V

7.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku i shoqërisë

7.3 Përgjegjësia e ortakut te shoqerise shtrihet ne perputhje me perqindjen e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

**NENI 8  
Kuotat, Fitimi i tyre, Transferimi i kuotave**

8.1 Kuotat e kapitalit te shoqërisë gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqërisë mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, dhurimit .

8.2 Transferimi i kuotave te kapitalit do te behet me Kontrate me shkrim ose me akt notarial .

Fitimi dhe transferimi i kuotave kanë efekt mbi shoqërinë nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve dhe i rregjistrimit ne Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

**KREU III  
ORGANET DREJTUESE  
NENI 9**

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt tatim pagues.

Organet kryesore të Shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshtë.



**NENI 10**  
**Asambleja e Ortakëve**

**10.1 Funksioni dhe Kompetencat :**

10.1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar te fushes ne fuqi, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen

Asambleja është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme por pa u kufizuar vetëm në to si :

- a) Percaktimin e politikave të biznesit;
- b) Ndryshimin e statutit;
- c ) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël;
- e) Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- f) Zbatimin dhe miratimin e pasqyrave financiare për llogaritë vjetore, të administrimit dhe të raporteve të mbikëqyrjes;
- g) Miratimin e rregullave proceduriale në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve;
- h) Miratimin e shpërndarjes së fitimit vjetor;
- i) Ristrukturim, prishjen, transforminin, bashkimin, likujdimin e shoqërisë ose riorganizimin e Shoqërisë në ndonjë formë tjetër Shoqërie;
- j) Marrjen e të gjitha masave me qëllim që të sigurohet që Shoqëria të ketë kapital dhe asete të mjaftueshme për ushtrimin e aktiviteti dhe përbushjen e detyrimeve kundrejt të tretëve ;
- k) të hipotekojë, lerë peng dhe vendose çdo barrë mbi asetet e veta dhe të lidhin çfarëdo marrëveshje financiare me çdo palë financuese,
- m) Krijimin, mbylljen dhe/ose prishjen e degëve, zyrave të përfaqësimit dhe filialeve
- m) Çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji dhe nga ky statut;

**10.2 Perfaqesimi ne Asamble**

Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet kur e ka te pamundur pjesemarrjen personalisht ne mbledhje, nga një person i trete. Autorizimi i leshuar personit te trete duhet te kete te percaktuar qarte tagrat e perfaquesuesit si dhe te drejtat e tij lidhur me vendimarrjen ne mbledhje.



## **NENI 11 ADMINISTRATORI**

11.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga Blerim Shahollari, i biri i Dashmirit, lindur me, 31.08.1992 ne Korçë dhe banues në Lumalas, Korçë ,posedues i leternjoftimit me numër personal :J20831023V .

11.2 Administratori do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë 1 (nje) vjeçare nga dita e depozitimit të statutit në QKB me te drejte riemerimi.

## **NENI 12 Kompetencat e administratorit**

12.1 Administratori i shoqërisë ka të drejtë e detyrohet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë. Ai ushtron të gjitha kompetencat sipas përcaktimeve të nenit 95 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare*”, i ndryshuar .

12.2 Administratori i shoqerise ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj.

12.3 Administratori ka te drejten e firmes se lirë dhe përfaqësimit te Shoqërisë ndaj të tretëve në veprime, procedura dhe seancë gjyqësore, si dhe pajtime dhe kompromise, pasi të këtë marrë vendimin e Asamblesë.

12.4 Administratori është përgjegjës, sipas rastit ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.

12.5 Kompetencat kryesore të Administratorit të shoqërisë janë:

- a) Të hartojë planet e llogarive ekonomike.
- b) Të hartojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- c) Të përfaqesojë Shoqerinë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj.
- d) Të përcaktojë strukturat e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- e) Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.
- f) Të vendosë rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), etj;
- g) Të përfaqësojë shoqerinë në regjistrin e pronës sipas këtij statuti.
- h) Të mbikqyrë dhe të zbatojë veprimtaritë dhe politikat tregtare të Shoqërisë
- i) Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin e zbatueshëm dhe standartet kontabël;
- j) Të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar të Shoqërisë;
- k) Të sigurojë që dokumentet dhe librat kontabël të Shoqërisë të mbahen në rregull dhe me saktësi;
- m) Të kryejë të gjitha regjistimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me shoqerinë , sipas parashikimeve të ligjit të zbatueshëm;



- p) Të miratojë hapjen e çdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre;  
q) Te kryeje çdo veprim tjeter te parashikuar ne ligji i cili nuk citohet shprehimisht ne Statut .

**KREU IV  
KUSHTET EKONOMIKE  
NENI 13**

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri; mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

**VEPRIMET EKONOMIKO-FINANCIARE  
NENI 14**

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin; vitin e parë në momentin e regjistrimit në QKB dhe në organet timore e mbyllen në 31 dhjetor të po atij viti, ndërsa per vitet ne vazhdim nisin në 1 Janar te çdo viti dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti.

**KREU V  
MARRËDHËNIET E PUNËS  
NENI 15**

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

**KREU VI  
DISPOZITA TË VEÇANTA  
NENI 16**

Shoqëria mund të prishet në çdo kohe dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore faktorë të tjerë që nuk varen nga ortaku apo per çdo shkak tjeter te parashikuar nga ligji.

**NENI 17  
ZGJIDHJA E MOSARREVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në shoqëri me të tretët, zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

**DISPOZITA TË FUNDIT  
NENI 18**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë, në bazë të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.



## NENI 19

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do ti bëhet referim Ligjit nr. 9901 datë 14/04//2008 "Për Tregëtaret dhe Shoqëritë Tregtare", te ndryshuar si dhe legjislacionit koherent. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

## NENI 20

Ky statut u përpilua nga Ortaku themelues duke shprehur vullnetin e tij të plotë e të lirë. Ai u përpilua në 3 (tre) kopje autentike, një kopje për t'u depozituar në QKB , një kopje ortaku i vetem i shoqerise dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU I VETEM  
I  
SHOQERISE D&A ENERGY SH.P.K**

BLERIM SHAHOLLARI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Blerim Shahollari' above a stylized signature.